



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_. \_\_. 2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 18.03.2024)*

*Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:07 dhe mbaroi në orën 12:10.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <i>(anëtar)</i>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <i>(anëtare)</i>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <i>(anëtare)</i>         |
| <b>5. Emona Muçi</b>      | <i>(anëtare)</i>         |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <i>(anëtar)</i>          |
| <b>7. Gentiana Muçaj</b>  | <i>(anëtare)</i>         |
| <b>8. Markelian Koça</b>  | <i>(anëtar)</i>          |
| <b>9. Yllka Rupa</b>      | <i>(anëtare)</i>         |

*Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Naureda Llagami, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Alban Toro.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
- 3. Denisa Varfi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 4. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

## **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e zgjedhjes së anëtarit në vendin vakant të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”, i përgatitur nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative. (pas hedhjes së shortit të orës 11:00).

***Ilir Rusi:*** Përshëndetje anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas njoftimit të bërë sot do zhvillojmë mbledhjen plenare të datës 18.03.2024, ora 12:00.

Ju bëj me dije që Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor është në një angazhim institucional dhe nuk ka mundësi objektive për të qenë prezent në këtë mbledhje, kështu që mbledhja do të drejtohet nga unë Ilir Rusi, zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu edhe zoti Toro për arsye objektive nuk mund të jetë prezent në këtë mbledhje (për arsye familjare).

Për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, mbledhjen e deklaroj të hapur dhe kemi për shqyrtim projektvendimin “Për miratimin e zgjedhjes së anëtarit në vendin vakant të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative. Për më tej fjalën relatores znj. Petriti.

***Etrita Petriti:*** Në zbatimit të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 128, datë 13.03.2024 ka miratuar listën përfundimtare të gjyqtarëve që do të marrin pjesë në hedhjen e shortit për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor.

Ditën e sotme datë 18.03.2024 ora 11:00, pranë ambienteve të Këshillit të Lartë Gjyqësor është zhvilluar hedhja e shortit ku në përfundim u zgjodh zonja {...} si anëtare për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar nenit 146 të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, pika 3, brenda 24 orësh nga hedhja e shortit, duhet të miratojë me vendim zgjedhjen e gjyqtares si anëtare të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Anëtari i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor i zgjedhur si më sipër do të ketë mandatin deri në përfundim të mandatit të anëtarëve aktualë të Kolegjit.

Për këtë arsye, propozojmë miratimin e projektvendimit si më poshtë:

Të miratojë zgjedhjen e anëtarit për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}

2. Zonja {...}, delegohet në këtë detyrë deri në përfundim të mandatit 4-vjeçar të anëtarëve të miratuar me vendimin nr.293, datë 09.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

***Ilir Rusi:*** Faleminderit!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Gentiana Muçaj:*** Dakord.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Markelian Koça:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Emona Muçi:*** Dakord.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për miratimin e zgjedhjes së anëtarit në vendin vakant të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Të miratojë zgjedhjen e anëtarit për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}.

2. Zonja {...} delegohet në këtë detyrë deri në përfundim të mandatit 4-vjeçar të anëtarëve të miratuar me vendimin nr. 293, datë 09.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me shqyrtimin e kësaj pike, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Javë të mbarë!

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**